



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 94, Datë 02.04.2026

MBI

**DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 193, DATË 18.09.2024
“MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “HPG ENERGY” SH.P.K. NË VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE”**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 02.04.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 874/1 prot., datë 31.03.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi disa ndryshime në vendimin e bordit të ERE-s nr. 193, datë 18.09.2024 “Mbi licencimin e shoqërisë “HPG ENERGY” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”

Konstatohet se:

1. Të dhëna mbi shoqërinë “HPG ENERGY” sh.p.k.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 193, datë 18.09.2024, ka licencuar shoqërinë “HPG ENERGY” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 2 MW, në Njësinë Administrative Topojë, Bashkia Fier, Qarku Fier, për një afat 30-vjeçar, me kushtet përkatëse.
- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 196, datë 15.08.2025, vendosi të ndryshojë pikat 2 dhe 3 të vendimit të sipërcituar, ku në pikën 2 të këtij vendimi u përcaktua detyrimi që shoqëria të fillojë ushtrimin e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike jo më vonë se data 16.12.2025, ndërsa në pikën 3 u përcaktua detyrimi të dokumentojë në ERE testimin e veprës brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga fillimi i operimit.
- Gjithashtu, në pikën 5 të vendimit nr. 193/2024, përcaktohet se: “Ky vendim është objekt rishikimi në rast se depozitohet/konstatohet një dokumentacion i ndryshëm nga ai që ka shërbyer për këtë vendimmarrje”.

2. Korrespondenca dhe dokumentacioni i depozituar nga shoqëria

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2711 prot., datë 22.10.2025, shoqëria ka raportuar përfundimin e punimeve, kryerjen e testeve nga OSSH sh.a. dhe fillimin e prodhimit të energjisë elektrike më datë 25.08.2025, në bazë të kontratës me FTL sh.a.
- Me shkresën nr. 2711/1 prot., datë 13.11.2025, ERE i ka kërkuar shoqërisë informacion në lidhje me testimin e veprës.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 874 prot., datë 10.03.2026, shoqëria ka depozituar në ERE shkresën e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN) nr. 1405/3 prot., datë

06.03.2026, me të cilën është përcjellë Raporti i Testimit i impiantit FV “HPG ENERGY” (2 MW), i kryer në terren nga grupi i punës. Sipas këtij raporti, testimi është zhvilluar në datat 26–27.01.2026, në vijim të kërkesës së shoqërisë të datës 26.08.2025.

3. Analiza ligjore dhe vlerësimi

- Rezulton se shoqëria ka kryer njoftimin për testimin e impiantit që në datën 26.08.2025, duke dëshmuar gatishmërinë për fillimin e prodhimit brenda afateve të përcaktuara në vendimet përkatëse të ERE-s. Si e tillë, vlerësohet se shoqëria ka përmbushur kushtin e përcaktuar në pikën 2, dhe me depozitimin e testimit të veprës, shoqëria ka plotësuar kushtin e përcaktuar në pikën 3 të vendimit nr. 196/2025, ndaj vlerësohet që këto pika të shfuqizohen.

4. Nevoja për ndryshimin e vendimit

- Në nenin 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, parashikohet se një akt administrativ mund të anulohet apo shfuqizohet nga organi publik që ka kompetencë të nxjerrë aktin..
- Në kushtet kur pikat 2 dhe 3 të vendimit nr. 193/2024, të ndryshuar, janë përmbushur, vlerësohet se duhet të shfuqizohen.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Miratimin e disa ndryshimeve në vendimin e bordit të ERE-s nr. 193, datë 18.09.2024, i ndryshuar, si vijon:
 - a) Pika 2 e vendimit të bordit të ERE-s nr. 193, datë 18.09.2024, i ndryshuar, shfuqizohet.
 - b) Pika 3 e vendimit të bordit të ERE-s nr. 193, datë 18.09.2024, i ndryshuar, shfuqizohet.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, të njoftojë shoqërinë “HPG ENERGY” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, shoqërinë “Furnizuesin e Tregut të Lirë” sh.a. dhe shoqërinë “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” sh.a. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI